

SKEMA E GRANTEVE PËR ENERGJI TË PASTËR

Udhëzues informues për Masën 1: Mbështetje për sistemet e energjisë solare dhe sistemet e baterive për ruajtjen e energjisë elektrike

KIESA, Ministria e Ekonomisë & LuxDev

AUTORITETI KONTRAKTUES:

Agjencia e Luksemburgut për Bashkëpunim Zhvillimor
(LuxDev)

AUTORITETI ZBATUES:

Agjencia për Investimeve dhe Përkrahjen e
Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA)

Tabela e përmbajtjes:

HYRJE: SKEMA E GRANTEVE PËR ENERGJI TË PASTËR.....	III
MASA 1: MBËSHTETJA PËR SISTEMET E ENERGJISË SOLARE DHE SISTEMET E BATERIVE PËR RUAJTJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE.....	1
1. APLIKIMI: SISTEMET E ENERGJISË SOLARE FOTOVOLTAIKE.....	3
1.1. Si të aplikoni	3
1.2. Dokumentet e kërkuara	3
1.3. Specifikimet teknike	3
2. APLIKIMI: SISTEMET SOLARE TERMIKE.....	4
2.1. Si të aplikoni	4
2.2. Dokumentet e kërkuara	4
2.3. Specifikimet teknike	4
3. APLIKIMI: SISTEMET E BATERIVE PËR RUAJTJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE.....	5
3.1. Si të aplikoni	5
3.2. Dokumentet e kërkuara	5
3.3. Specifikimet teknike	5
4. RREGULLAT DHE KUSHTET E PËRGJITHSHME.....	6
4.1. Shpenzimet e pranueshme dhe kushtet e pagesave	6
4.2. Kriteret për vlerësim	6
LISTA E SHTOJCAVE	8
5. SHTOJCA 1: SISTEMET SOLARE FOTOVOLTAIKE – FORMULARI TEKNIK	8
6. SHTOJCA 2: SISTEMET SOLARE TERMIKE– FORMULARI TEKNIK	11
7. SHTOJCA 3: SISTEMET E BATERIVE PËR RUAJTJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE- FORMULARI TEKNIK.....	13

HYRJE: SKEMA E GRANTEVE PËR ENERGJI TË PASTËR

Skema e Granteve për Energji të Pastër ka një buxhet prej **€1,000,000** dhe synon të mbështesë të gjitha Ndërmarrjet Mikro, të Vogla dhe të Mesme (NMVM¹) dhe bizneset e mëdha që kanë hyrë në tregun e liberalizuar të energjisë elektrike me aktivitete parësore ose dytësore në prodhim dhe përpunim. Skema bashkëfinancon investime që përmirësojnë performancën energjetike dhe ulin kostot e energjisë elektrike përmes: (i) gjenerimit të energjisë së ripërtërishme (sistemet solare fotovoltaike dhe termike), (ii) ruajtjes të energjisë elektrike nga sistemet solare fotovoltaike përmes baterive, (iii) masave të efijencës së energjisë në ndërtesat e bizneseve, dhe (iv) pajisjeve që ulin konsumin e energjisë në linjat e prodhimit.

Fokus i veçantë do t'u jepet ndërmarrjeve më të prekura nga tregu i hapur i energjisë elektrike, projektet e të cilave synojnë të rrisin efijencën e energjisë dhe përdorimin e energjisë së ripërtërishme.

Përmes financimit të këtyre investimeve, skema synon të stimulojë angazhimin e sektorit privat në tranzicionin energjetik të Kosovës duke përdorur teknologji të qëndrueshme të prodhimit, duke rritur efijencën e energjisë dhe duke ulur kostot operative².

Skema e Granteve për Energji të Pastër zbatohet përmes tri thirrjeve të veçanta publike, të cilat përfshijnë masat e mëposhtme:

- **Masa 1:** Mbështetje për sistemet e energjisë solare dhe sistemet e baterive për ruajtjen e energjisë elektrike.
- **Masa 2:** Mbështetje për masat e efijencës së energjisë në ndërtesat e bizneseve.
- **Masa 3:** Mbështetje për pajisjet që ulin konsumin e energjisë në linjat e prodhimit.

Aplikuesit mund të aplikojnë për secilën nga tri Masat (Masa 1, 2 ose 3) individualisht, me një mbështetje maksimale deri në **20,000 €** për secilën Masë të vetme. Masa 1 dhe 2 mund të kombinohen secila me Masën 3, por në këtë rast mbështetja totale nuk mund të kalojë vlerën prej **25,000 EUR**. Megjithatë, përfituesit nuk mund të përfitojnë njëkohësisht nga Masa 1 dhe Masa 2. Informatat në lidhje me shumën e granteve të ndara për secilën prej masave gjenden në Tabelën 1.

Tabela 1: Masat e mbështetura dhe shumën e granteve të ndara për secilën prej masave

Skema e Granteve për Energji të Pastër	Vlera maksimale e grantit	Financuar nga granti	Informata shtesë
Masa 1: Mbështetja për sistemet e energjisë solare dhe sistemet e baterive për ruajtjen e energjisë elektrike.	€ 20,000	Energji solare (FV): 100 €/kWp Bateri për ruajtje të energjisë: 130 €/kW Sistemi solar termik: 40% e investimit total (deri në 300 €/m ² të sipërfaqes me panele solare).	Mund të kombinohet me Masën 3. Mbështetja maksimale për masat e kombinuara: € 25,000.
Masa 2: Mbështetja për masat e efijencës së energjisë në ndërtesat e bizneseve.	€ 20,000	30% e shumës totale të investimit	Mund të kombinohet me Masën 3. Mbështetja maksimale për masat e kombinuara: € 25,000.
Masa 3: Mbështetja për pajisjet që ulin konsumin e energjisë në linjat e prodhimit.	€ 20,000	70% e vlerës së pajisjes dhe deri në 65 €/kW.	Mund të kombinohet me Masën 1 ose 2. Mbështetja maksimale për masat e kombinuara: 25.000€.

¹ Bazuar në Ligjin Nr. 04/L-220.

² Përfituesit e skemës së granteve do të përfitojnë edhe nga trajnime dhe mbështetje teknike që ndihmojnë në përdorimin më efikas të energjisë dhe në zhvillimin e praktikave të qëndrueshme. Këto shërbime kanë për qëllim t'i pajisin ata me njohuri praktike për të zbatuar masa të efijencës dhe energjisë së ripërtërishme në mënyrë të qëndrueshme.

MASA 1: MBËSHTETJA PËR SISTEMET E ENERGJISË SOLARE DHE SISTEMET E BATERIVE PËR RUAJTJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE

Masa 1 e Skemës së Granteve të Energjisë së Pastër mbështet investimet në këto tri (3) nën-masa:

- Sistemet solare fotovoltaike.
- Sisteme solare termike.
- Sistemet e baterive për ruajtjen e energjisë elektrike.

Aplikuesit që kualifikohen³: Për t'u kualifikuar për grantin, aplikuesit duhet të plotësojnë **të gjitha kushtet në vijim**:

- Të jetë i regjistruar si ndërmarrje e sektorit privat, nga 1 janari 2024 ose më herët, në përputhje me legjislacionin në fuqi në Kosovë.
- Të jetë kompani prodhuese ose përpunuese⁴ (domethënë prodhues, jo tregtar ose ofrues shërbimesh).
- Të gjitha ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme prodhuese ose përpunuese kualifikohen⁵ për aplikim. Gjithashtu, të gjitha kompanitë prodhuese ose përpunuese që nuk furnizohen më nga tarifa e rregulluar e energjisë elektrike, kualifikohen për këtë thirrje.

Aplikuesit mund të aplikojnë për një, dy ose për të tri nën-masat në kuadër të Masës 1, por shuma totale e grantit për këtë masë nuk mund të kalojë **€20,000**. Aplikuesit mund të kombinojnë Masën 1 (të gjitha nën-masat) me Masën 3, por shuma maksimale e grantit nuk mund të kalojë **€25,000**. Granti i dedikohet vetëm aktiviteteve prodhuese/përpunuese.

Tabela 2 jep detaje mbi shumat maksimale të granteve për secilën nën-masë në kuadër të Masës 1.

Tabela 2: Shumat maksimale të grantit për Masën 1.

MASA 1:	PËRSHKRIMI	SHUMA MAKSIMALE E GRANTIT	KËRKESAT
A. Sistemet e energjisë solare fotovoltaike (FV)	Për të prodhuar energji elektrike.	100 €/kWp (duke përfshirë kostot e instalimit), deri në 20,000 €.	- Vetëm një sistem për aplikues. - Sistemi duhet të jetë i ri. - Kapaciteti i propozuar duhet të jetë në përputhje me Rregullën për vet-konsumatorët me burime të ripërtëritshme. - Projekti duhet të përgatitet nga një kompani instaluese e regjistruar në Kosovë me minimum 1 vit operimi⁶ në tregun e Kosovës.
B. Sistemet solare termike	Për të ngrohur ujin sanitar.	40% e vlerës totale të investimit për sistemin e plotë solar termik, deri në maksimum 300 €/m ² të sipërfaqes me panele solare (duke përfshirë kostot e	- Vetëm një sistem për aplikues. - Sistemi duhet të jetë i ri. - Projekti duhet të përgatitet nga një kompani instaluese e regjistruar në Kosovë me minimum 1 vit operimi⁶ në tregun e Kosovës.

³ Në një version të mëparshëm të udhëzuesit është paraqitur një gabim teknik, i cili nuk e ka sqaruar në mënyrë të plotë targetin e thirrjes dhe bizneset që kualifikohen për grante.

⁴ Të gjithë sektorët me aktivitete parësore dhe dytësore në prodhim dhe përpunim.

⁵ Bazuar në Ligjin Nr. 04/L-220.

⁶ Verifikuar përmes certifikatës së biznesit.

		instalimit). Shuma maksimale e grantit është €20,000.	
C. Sistemet e baterive për ruajtjen e energjisë elektrike	Për të ruajtur energjinë elektrike.	130 €/kW (duke përfshirë kostot e instalimit), deri në 20,000 €.	• Vetëm një sistem për aplikues. • Sistemi duhet të jetë i ri. • Projekti duhet të përgatitet nga një kompani instaluese e regjistruar në Kosovë me minimum 1 vit operimi⁶ në tregun e Kosovës. Të përmbushet një nga kërkesat e mëposhtme: - Aplikuesi ka të instaluar një sistem fotovoltaiik (FV) ekzistues (Dëshmi: fotografi e sistemit fotovoltaiik), ose - Aplikuesi është në proces të instalimit të një sistemi solar fotovoltaiik si prosumator (Dëshmi: pëlqimi për kyçje në rrjet nga KEDS), ose - Aplikuesi është në proces të instalimit të një sistemi solar fotovoltaiik pas njehsorit: (Dëshmi: Projekt-propozim nga kompania instaluese, me kusht që sistemi solar fotovoltaiik të jetë i përfunduar dhe i instaluar para disbursimit të plotë të grantit).

1. APLIKIMI: SISTEMET E ENERGJISË SOLARE FOTOVOLTAIKE

1.1. Si të aplikoni

Procesi i aplikimit është i ndarë në dy (2) faza:

Faza 1: Parakualifikimi

1. Aplikacionet dorëzohen online përmes platformës e-Kosova (seksioni 1.2: Dokumentet e kërkuara – Faza 1).
2. Komisioni i Vlerësimit verifikon dokumentet dhe zbaton kriteret e vlerësimit me pikë (seksioni 4.2).
3. Aplikuesit njoftohen për rezultatet e vlerësimit përmes platformës e-Kosova.
4. Lista e aplikuesve që janë vlerësuar me më së shumti pikë dhe janë parakualifikuar për grant publikohet në faqen e internetit të KIESA-s.
5. Aplikuesit e parakualifikuar nënshkruajnë kontratën për grant.
6. Aplikuesi i parakualifikuar mund të zgjedhë nëse dëshiron të pranojë një pagesë të pjesshme paraprake nga granti, ose të marrë rimbursimin e plotë pas fazës së dytë (seksioni 4.1: Shpenzimet e pranueshme dhe kushtet e pagesave).

Faza 2: Disbursimi final për aplikuesit e parakualifikuar

1. Të gjitha dokumentet e kërkuara të Fazës 2 dorëzohen në MINT për komisionin monitorues (seksioni 1.2: Dokumentet e kërkuara – Faza 2).
2. Dokumentet e dorëzuara do të shqyrtohen nga komisioni përkatës dhe, pas inspektimit të sistemit të instaluar, aplikuesit e parakualifikuar do të marrin konfirmim nëse dokumentet e tyre janë në përputhje me kriteret e thirrjes.

1.2. Dokumentet e kërkuara

Përveç dokumenteve që do të kërkohen për aplikim sipas Udhëzimit Administrativ 01/2018 dhe që do të bëhen publike në Thirrjen Zyrtare, bizneset mund të fillojnë përgatitjen paraprake të dokumenteve të listuara më poshtë. Këto dokumente do t'ju ndihmojnë të përshpejtoni aplikimin tuaj kur thirrja të hapet.

1. Pëlqimi komunal (i lëshuar më 1 qershor 2025 ose më vonë).
2. Pëlqimi për kyçje në rrjet (i lëshuar më 1 qershor 2025 ose më vonë).
3. Konsumi total i energjisë elektrike 2024 (EUR dhe kWh) (dokument nga furnizuesi KESCO ose furnizues të tjerë).

1.3. Specifikimet teknike

Aplikuesi dhe kompania instaluese/implementuese duhet të sigurohen që sistemi i propozuar solar fotovoltaik i përmbush kriteret minimale teknike të përcaktuara në **Shtojcën 1: Sistemet solare fotovoltaike – Formulari Teknik**. Ky formular duhet të plotësohet dhe të nënshkruhet nga kompania instaluese/implementuese, duke konfirmuar përputhshmërinë me kërkesat teknike.

2. APLIKIMI: SISTEMET SOLARE TERMIKE

2.1. Si të aplikoni

Procesi i aplikimit është i ndarë në dy (2) faza:

Faza 1: Parakualifikimi

1. Aplikacionet dorëzohen online përmes platformës e-Kosova (seksioni 2.2: Dokumentet e kërkuara – Faza 1).
2. Komisioni i Vlerësimit verifikon dokumentet dhe zbaton kriteret e vlerësimit me pikë (seksioni 4.2).
3. Aplikuesit njoftohen për rezultatet e vlerësimit përmes platformës e-Kosova.
4. Lista e aplikuesve që janë vlerësuar me më së shumti pikë dhe janë parakualifikuar për grant publikohet në faqen e internetit të KIESA-s.
5. Aplikuesit e parakualifikuar nënshkruajnë kontratën për grant.
6. Aplikuesi i parakualifikuar mund të zgjedhë nëse dëshiron të pranojë një pagesë të pjesshme paraprake nga granti, ose të marrë rimbursimin e plotë pas fazës së dytë (seksioni 4.1: Shpenzimet e pranueshme dhe kushtet e pagesave).

Faza 2: Disbursimi final për aplikuesit e parakualifikuar

1. Të gjitha dokumentet e kërkuara të Fazës 2 dorëzohen në MINT për komisionin monitorues (seksioni 2.2: Dokumentet e kërkuara – Faza 2).
2. Dokumentet e dorëzuara do të shqyrtohen nga komisioni përkatës dhe, pas inspektimit të sistemit të instaluar, aplikuesit e parakualifikuar do të marrin konfirmim nëse dokumentet e tyre janë në përputhje me kriteret e thirrjes.

2.2. Dokumentet e kërkuara

Përveç dokumenteve që do të kërkohen për aplikim sipas Udhëzimit Administrativ 01/2018 dhe që do të bëhen publike në Thirrjen Zyrtare, bizneset mund të fillojnë përgatitjen paraprake të dokumenteve të listuara më poshtë. Këto dokumente do t'ju ndihmojnë të përshpejtoni aplikimin tuaj kur thirrja të hapet.

1. Konsumi total i energjisë elektrike 2024 (EUR dhe kWh) (dokument nga furnizuesi KESCO ose furnizues të tjerë).

2.3. Specifikimet teknike

Aplikuesi dhe kompania instaluese/implementuese duhet të sigurohen që Sistemi Solar Termik i propozuar i përmbush kriteret minimale teknike të përcaktuara në **Shtojcën 2: Sistemi Solar Termik – Formulari Teknik**. Ky formular duhet të plotësohet dhe të nënshkruhet nga kompania instaluese/ implementuese, duke konfirmuar përputhshmërinë me kërkesat teknike.

3. APLIKIMI: SISTEMET E BATERIVE PËR RUAJTJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE

3.1. Si të aplikoni

Procesi i aplikimit është i ndarë në dy (2) faza:

Faza 1: Parakualifikimi

1. Aplikacionet dorëzohen online përmes platformës e-Kosova (seksioni 3.2: Dokumentet e kërkuara – Faza 1).
2. Komisioni i Vlerësimit verifikon dokumentet dhe zbaton kriteret e vlerësimit me pikë (seksioni 4.2).
3. Aplikuesit njoftohen për rezultatet e vlerësimit përmes platformës e-Kosova.
4. Lista e aplikuesve që janë vlerësuar me më së shumti pikë dhe janë parakualifikuar për grant publikohet në faqen e internetit të KIESA-s.
5. Aplikuesit e parakualifikuar nënshkruajnë kontratën për grant.
6. Aplikuesi i parakualifikuar mund të zgjedhë nëse dëshiron të pranojë një pagesë të pjesshme paraprake nga granti, ose të marrë rimbursimin e plotë pas fazës së dytë (seksioni 4.1: Shpenzimet e pranueshme dhe kushtet e pagesave).

Faza 2: Disbursimi final për aplikuesit e parakualifikuar

1. Të gjitha dokumentet e kërkuara të Fazës 2 dorëzohen në MINT për komisionin monitorues. (seksioni 3.2: Dokumentet e kërkuara – Faza 2).
2. Dokumentet e dorëzuara do të shqyrtohen nga komisioni përkatës dhe, pas inspektimit të sistemit të instaluar, aplikuesit e parakualifikuar do të marrin konfirmim nëse dokumentet e tyre janë në përputhje me kriteret e thirrjes.

3.2. Dokumentet e kërkuara

Përveç dokumenteve që do të kërkohen për aplikim sipas Udhëzimit Administrativ 01/2018 dhe që do të bëhen publike në Thirrjen Zyrtare, bizneset mund të fillojnë përgatitjen paraprake të dokumenteve të listuara më poshtë. Këto dokumente do t'ju ndihmojnë të përshpejtoni aplikimin tuaj kur thirrja të hapet.

1. Konsumi total i energjisë elektrike 2024 (EUR dhe kWh) (dokument nga furnizuesi KESCO ose furnizues të tjerë).

3.3. Specifikimet teknike

Aplikuesi dhe kompania instaluese/implementuese duhet të sigurohen që Sistemi i propozuar i baterive për ruajtjen e energjisë elektrike përmbush kriteret minimale teknike të përcaktuara në **Shtojcën 3: Sistemi i Baterive për Ruajtjen e Energjisë Elektrike – Formulari Teknik**. Ky formular duhet të plotësohet dhe të nënshkruhet nga kompania instaluese/ implementuese, duke konfirmuar përputhshmërinë me kërkesat teknike.

4. RREGULLAT DHE KUSHTET E PËRGJITHSHME

4.1. Shpenzimet e pranueshme dhe kushtet e pagesave

Shpenzimet e pranueshme janë vetëm ato shpenzime që janë kryer realisht, të vërtetuara me fatura të rregullta dhe transaksione bankare. Të gjitha shpenzimet duhet të jenë në përputhje me rregullat e përcaktuara nga kjo thirrje. Vetëm "shpenzimet e pranueshme" mund të merren në konsideratë për grantin. Kostot e pranueshme duhet të bazohen në shpenzimet aktuale të parashikuara në propozimin e projektit dhe në dokumentet mbështetëse.

Aplikuesit kanë dy mundësi për të marrë fondet e grantit:

Opsioni 1: Rimbursimi i plotë

- Përfituesi merr shumën e plotë të grantit, pas përfundimit të verifikimit përfundimtar.

Opsioni 2: Pagesa e paradhënies

- Aplikuesit mund të kërkojnë një paradhënie prej 50% të vlerës së grantit pas nënshkrimit të marrëveshjes (pas përfundimit me sukses të Fazës 1).
- Kushtet për pagesën e paradhënies: Për të marrë një pagesë paradhënieje, përfituesi është i obliguar të sjellë një Garanci të vlefshme për 50% të grantit, të lëshuar nga një Institucion Financiar i Regjistruar (RFI), i licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK).
- Shuma e mbetur prej 50% paguhet pas dorëzimit dhe miratimit të plotë të dokumentacionit sipas kërkesave të Fazës 2.

4.2. Kriteret për vlerësim

Përfitues do të jenë ato biznese që janë renditur me numrin më të lartë të pikëve nga komisioni, në varësi të kufizimeve buxhetore. Vetëm lista e bizneseve përfituese të përzgjedhura do të publikohet në faqen e internetit (<https://kiesa.rks-gov.net/page.aspx?id=1.134>).

Para se të zbatohen kriteret e vlerësimit me pikë, të përcaktuara në tabelën më poshtë, të gjitha aplikimet do t'i nënshtrohen fillimisht një shqyrtimi paraprak në Fazën 1. Ky shqyrtim do të verifikojë nëse dokumentet janë dorëzuar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në thirrjen publike për masën/masat e përzgjedhura. Aplikimet që nuk i plotësojnë këto kërkesa nuk do të kalojnë në fazën e vlerësimit me pikë.

Aplikimet që plotësojnë kërkesat e Fazës 1 do të vlerësohen dhe do tu jepen pikët bazuar në kriteret e ponderuara të përshkruara më poshtë. Renditja përfundimtare do të përcaktohet në bazë të pikëve të përgjithshme të vlerësuara.

Vetëm aplikuesit që përzgjidhen pas procesit të vlerësimit me pikë do të vazhdojnë në Fazën 2. Në Fazën 2, përfituesit duhet të dorëzojnë të gjithë dokumentacionin e kërkuar siç përcaktohet në Thirrje dhe në kontratë. Komisioni do të verifikojë përmbushjen e të gjitha kërkesave para se të bëhen pagesat. Rimbursimi do të realizohet vetëm pasi të jenë verifikuar dhe miratuar të gjitha kriteret dhe dokumentet e Fazës 2.

Tabela 3: Kriteret e vlerësimit [me pikë]

Kategoria	Kriteret	Pikët
1. Ekspozimi ndaj çmimeve të energjisë elektrike të bazuara në treg	Kompania nuk përfiton nga tarifat e rregulluara të energjisë elektrike.	45

2. Intensiteti ⁷ i energjisë (elektrike)	Niveli i intensitetit të energjisë (elektrike) në operacionet e biznesit.	20
3. Ndikimi ⁸ i Energjisë (elektrike)	Ndikimi i kostove të energjisë (elektrike) në performancën e biznesit.	20
4. Gjithëpërfshirja	Përfshirja Sociale: Kompania: (a) është në pronësi, në bashkëpronësi ose udhëhiqet nga një grua (në pronësi ose bashkëpronësi), (5 pikë) (b) është në pronësi, në bashkëpronësi ose udhëhiqet nga minoritetet, (5 pikë) (c) punëson një numër të konsiderueshëm grash (të paktën 30% e stafit të përgjithshëm) (5 pikë)	15

Me rëndësi: Në rast se numri i aplikimeve që i plotësojnë kushtet tejkalon buxhetin e financimit në dispozicion, Autoriteti Kontraktues rezervon të drejtën për të aplikuar kriter shtesë si pjesë të procesit përfundimtar të përzgjedhjes. Ky kriter do të vlerësojë pjesën e fondeve të veta të angazhuara nga aplikuesi në raport me koston totale të investimit, duke u dhënë përparësi propozimeve që demonstrojnë nivele më të larta bashkëfinancimi.

⁷ Ky indikator llogaritet duke pjesëtuar konsumin total vjetor të energjisë elektrike (në kWh) gjatë vitit 2024 me qarkullimin total vjetor të biznesit (në euro) për të njëjtin vit.

⁸ Ky indikator llogaritet duke pjesëtuar shpenzimet totale vjetore për energji elektrike (në €) gjatë vitit 2024 me fitimin operativ total vjetor të biznesit (në €) për të njëjtin vit.

LISTA E SHTOJCAVE

5. SHTOJCA 1: SISTEMET SOLARE FOTOVOLTAIKE – FORMULARI TEKNIK

Formulari për aplikim: Sistemet e energjisë solare fotovoltaike		
1. Të dhënat e aplikuesit		
Emri i biznesit		
Numri Unik Identifikues (NUI)		
Adresa e biznesit ku do të instalohet sistemi solar fotovoltaik		
Vendi		
Telefoni		
Të dhënat e mëposhtme duhet të plotësohen nga kompania instaluese		
2. Informacion në lidhje me konsumin e energjisë		
Shifra e konsumatorit të furnizuesit	_____	☐ Projekti i propozuar FV ka pëlqimin nga KEDS
Niveli i tensionit të kçjes:	_____ kV	
Grupi tarifar (nëse zbatohet):		
3. Të dhënat e sistemit fotovoltaik (FV)		
Kapaciteti i sistemit fotovoltaik:	_____ kWp	
Prodhimi vjetor i sistemit fotovoltaik:	_____ kWh	
Konsumi vjetor i objektit:	_____ kWh	
Kostoja totale e sistemit fotovoltaik:	_____ Euro	
Kostoja specifike e sistemit fotovoltaik:	_____ Euro/kWp	
Hapësira e mbuluar nga modulet fotovoltaike:	_____ m ²	
Plani kohor i realizimit (ditë/muaj):	_____	
☐ Objekti i propozuar fotovoltaik ka pëlqimin nga Komuna		
4. Informacion mbi Kompaninë Instaluese		
Emri i biznesit të instaluesit		
Numri i biznesit të instaluesit (NUI)		
E-mail adresa		
Numri i telefonit		
5. Kriteret teknike të përzgjedhura për verifikim		
Të dhënat e pajisjes:	Kriteret e kërkuara për verifikim (shënoni me një X nëse plotësohet kriteri)	
Modulet fotovoltaike (FV)	☐ Eficienca e moduleve fotovoltaike (FV) në kushtet standarde të testimit (STC) të mos jetë më e vogël se njëzetë përqind (20 %). ☐ Të pajisur me certifikatën e konformitetit CE.	

Inverteri	☐ Eficienca maksimale e inverterit të mos jetë më e vogël se 97%. ☐ Të pajisur me certifikatën e konformitetit CE.
6. Kriteret minimale teknike të kërkuara: (shënoni me X nëse plotësohet kriteri)	
Modulet fotovoltaike (FV)	☐ Modulet fotovoltaike (FV) duhet të jenë të kualifikuara konform IEC (International Electrotechnical Commission) aktuale apo certifikime tjera ndërkombëtare valide për tregun e Bashkimit Evropian siç janë: • ISO – International Standardization Organization • EN - European Standards • IEEE Institute of Electrical and Electronics Engineers ☐ Fuqia nominale e moduleve fotovoltaike është > 250 Wp ☐ Eficienca e moduleve fotovoltaike (FV) në kushtet standarde të testimit (STC) të mos jetë më e vogël se njëzetë përqind (20 %). ☐ Modulet fotovoltaike (FV) duhet të jenë të garantuara për së paku dhjetë (10) vite ndaj dështimeve për shkak të defekteve dhe cilësisë së materialeve. ☐ Modulet fotovoltaike (FV) duhet të kenë degradim linear të fuqisë jo më shumë se 0.8% në vit deri në vitin e njëzet e pestë (25) të operimit (duke përjashtuar vitin e parë të funksionimit). ☐ Gama e temperaturës të mos jetë më e ulët se -30 °C deri + 50 °C ☐ Korniza e moduleve fotovoltaike (FV) duhet të jetë e përbërë nga materiale rezistuese ndaj korrozionit. ☐ Ngarkesa e lejuar e borës/erës: jo më pak se 5300 Pa / 2300 Pa. ☐ Të pajisur me certifikatën e konformitetit CE.
Inverteri	☐ Inverteri/ët duhet të jetë i/të kualifikuar(a) konform (International Electrical Code -IEC) aktuale apo certifikime tjera ndërkombëtare valide për tregun e Bashkimit Evropian. ☐ Inverteri duhet të ketë të garanci ≥ 5 vite. ☐ Eficienca maksimale e inverterit të mos jetë më e vogël se 97%. ☐ Gama e temperaturës të mos jetë më e ulët se -20 °C deri + 50 °C. ☐ Gama e ndryshimit të frekuencës brenda: 45-55 Hz. ☐ Shkalla e mbrojtjes (sipas IEC 60529) minimale me IP 65 (ambient i jashtëm) dhe IP 20 (ambient i brendshëm). ☐ Inverteri duhet të ketë një sistem të brendshëm (të integruar) të mbrojtjes: • Mbrojtja nga mbirryma në anën AC dhe DC • Mbrojtje nga mbitensioni/nëntensioni AC • Mbrojtje nga mbifrekuenca/nënfrekuenca AC • Mbrojtja kundër polaritetit të kundërt të lidhjes në anën DC • Mbrojtje kundër funksionimit të pavarur nga rrjeti (Anti-islanding). ☐ Inverteri duhet të jetë i pajisur me një aplikacion ekran/online për të monitoruar të dhënat e paraqitura si më poshtë: • Fuqia DC në hyrje • Tensioni DC në hyrje • Rryma DC • Fuqia AC në dalje • Tensioni AC në dalje • Rryma AC në dalje ☐ Të pajisur me certifikatën e konformitetit CE.
Kabllo	☐ Kabllot duhet të jenë të kualifikuara konform IEC aktuale apo certifikime tjera ndërkombëtare valide për tregun e Bashkimit Evropian. ☐ Kabllot duhet të jenë kompatible për sistemet fotovoltaike (FV) që mund t'i rezistojnë kushteve të vështira mjedisore, duke përfshirë temperaturat e larta, rrezatimin UV, shiun, lagështinë, papastërtitë, ekspozimin ndaj mikrobeve dhe tensionet sipas standardeve më të fundit të IEC. ☐ Të pajisur me certifikatën e konformitetit CE.
	☐ Struktura montuese duhet të projektohet në atë mënyrë që të përballojë shpejtësinë e erës në zonat ku propozohet të instalohen sistemet fotovoltaike (FV).

Dizajni i strukturës për montimin e moduleve fotovoltaike (FV)	Dizajni i strukturës për montimin e moduleve fotovoltaike në çati duhet të jetë i përshtatshëm me faktor të sigurisë jo më të vogël se 1.5.
Kutitë Shpërndarëse (nëse ka)	☐ Të gjitha kutitë duhet të jenë të pajisura me elementet adekuate mbrojtëse, funksionalitetin e duhur dhe sigurinë (përfshirë siguresat, tokëzimin, etj). ☐ Kutitë duhet të jenë të papërshkrueshme nga uji, parazitët, pluhuri, dhe duhet të jenë të prodhuar nga materiale termoplastike / metalike në përputhje me IEC 62208, rezistent ndaj rrezeve UV (ultraviolete) dhe ndaj zjarrit, si dhe të ketë mbrojtje minimale me IP 65 (ambient të jashtëm) dhe IP 20 (ambient të brendshëm). ☐ Të pajisur me certifikatën e konformitetit CE.
Deklaroj se projekti: "Sistemi solar fotovoltaike" është në përputhje me kërkesat e Rregullores së ZRRE-së për vet-konsumatorët me burime të ripërtëritshme dhe përmbush të gjitha standardet teknike të përcaktuara në këtë Thirrje.	----- Emri dhe mbiemri, nënshkrimi i personit përgjegjës të autorizuar nga kompania instaluese dhe vula

Emri dhe Mbiemri i aplikuesit

Data

Nënshkrimi

Vendi

6. SHTOJCA 2: SISTEMET SOLARE TERMIKE- FORMULARI TEKNIK

Formulari për aplikim: Sistemi Solar Termik	
1. Të dhënat e aplikuesit	
Emri i biznesit që aplikon:	
Numri Unik Identifikues (NUI) i biznesit	
Adresa e biznesit ku do të instalohet sistemi solar termik	
Vendi	
Telefoni	
Të dhënat e mëposhtme duhet të plotësohen nga kompania instaluese	
2. Sistemi Solar Termik	
Lloji i paneleve solare:	☐ panel me tuba të vakumuar ☐ panel të rrafshët
Numri i paneleve:	_____copë
Sipërfaqja totale e paneleve solare:	_____m ²
Kapaciteti i vëllimit të akumuluesit të nxehtësisë/bojlerit:	_____litra
Kostoja e vlerësuar sipas ofertës për sistemin solar për ngrohjen e ujit sanitar për m ² :	_____Euro/ m ²
Kostoja totale e vlerësuar sipas ofertës për sistemin solar për ngrohjen e ujit sanitar:	_____Euro
3. Informacion mbi Kompaninë Instaluese	
Emri i biznesit të instaluesit:	
Numri i biznesit të instaluesit (NUI):	
E-mail adresa:	
Numri i telefonit:	
4. Kriteret e përzgjedhura për verifikim	
Të dhënat e pajisjes:	Kriteret e kërkuara për verifikim (<i>shënoni me një X nëse plotësohet kriteri</i>)
Paneli solar	☐ Eficienca termike $\eta \geq 56\%$ ose eficienca me zero-humbje > 0.75 ☐ E pajisur me certifikatën e konformitetit CE.
Akumulatori / bojleri i nxehtësisë:	☐ Klasa minimale e energjisë "C". ☐ E pajisur me certifikatën e konformitetit CE. ☐ Kapaciteti – vëllimi i akumuluesit/bojlerit të nxehtësisë prej 150L e më të lartë sipas nevojave për ujë të ngrohtë.
Moduli i pompimit	☐ Indeksi i efijencës së energjisë EEI duhet të jetë ≤ 0.23 . ☐ E pajisur me certifikatën e konformitetit CE
5. Kriteret minimale teknike të kërkuara: (shënoni me X nëse plotësohet kriteri)	

Panele solare termike (panel solar me tub vakumi ose panel solar i sheshtë)	☐ E pajisur me certifikatën e konformitetit CE. ☐ Eficienca termike $\eta \geq 56\%$ ose eficienca me humbje zero > 0.75 ☐ Absorbimi $>$ nëntëdhjetë (90). ☐ I konstruktuar me cilësi të lartë, rezistente ndaj goditjeve, duke përdorur qelqin solar rezistent ndaj goditjes, anti-reflektues. ☐ Tubi i absorbuesit nga bakri, me portet për sensorët e temperaturës dhe çajrosjes së panelit. ☐ Koeficienti termik $k_1 > 3.8 \text{ } \ddot{\text{E}}/\text{m}^2\text{K}$. ☐ Koeficienti i ngrohjes $k_2 > 0.01 \text{ } \ddot{\text{E}} / \text{m}^2\text{K}^2$. ☐ Izolim R10 pllakë shkume poli isocyanate ose lesh mineral me përçueshmëri termike $0.035 \ddot{\text{E}}/\text{mK}$. ☐ I përshtatshëm për instalim sipas DIN 1988, EN 12828 dhe DIN 4753. ☐ Temperatura e stagnimit $< 200 \text{ } ^\circ\text{C}$. ☐ Presioni maksimal punues dhjetë (10) bar. ☐ Mediumi për transferim të nxehtësisë: Glykol.
Akumulatori i nxehtësisë / bojleri	☐ Kapaciteti – vëllimi i akumuluesit të nxehtësisë/bojlerit prej 150 litra e më lartë, sipas nevojave për ujë të ngrohtë. ☐ Klasa e energjisë duhet të jetë minimale "C". ☐ I pajisur me certifikatën e konformitetit CE.
Moduli i pompimit	☐ Indeksi i efijencës së energjisë EEI duhet të jetë ≤ 0.23. ☐ I pajisur me certifikatën e konformitetit CE.
Deklaroj se projekti: "Sistemi solar termik" i plotëson të gjitha standardet teknike të përcaktuara në këtë thirrje.	----- Emri dhe mbiemri, nënshkrimi i personit përgjegjës të autorizuar nga kompania instaluese dhe vula

Emri dhe Mbiemri i aplikuesit

Data

Nënshkrimi

Vendi

7. SHTOJCA 3: SISTEMET E BATERIVE PËR RUAJTJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE-FORMULARI TEKNIK

Formulari për aplikim: Sistemi i baterive për ruajtjen e energjisë elektrike	
1. Të dhënat e aplikuesit:	
Emri i biznesit që aplikon	
Numri Unik Identifikues (NUI) i biznesit	
Adresa e biznesit ku do të instalohen pajisjet	
Vendi	
Telefoni	
Të dhënat e mëposhtme duhet të plotësohen nga kompania instaluese	
2. Sistemi i baterive për ruajtjen e energjisë elektrike	
Kapaciteti i akumulimit (ruajtjes) së energjisë:	_____ kWh
Fuqia	_____ kW
Integrimi me sistemet fotovoltaike:	☐ Aplikuesi ka të instaluar një sistem fotovoltaike (FV) ekzistues dhe kapaciteti i instaluar i sistemit PV është _____ kWp. ☐ Aplikuesi është në proces të instalimit të një sistemi solar fotovoltaike si prosumator, me kapacitet të parashikuar të sistemit PV prej _____ kWp. ☐ Aplikuesi është në proces të instalimit të një sistemi solar fotovoltaike pas njehsorit, me kapacitet të parashikuar të sistemit PV prej _____ kWp.
Kostoja specifike e sistemit:	_____ Euro/kWh
Kosto totale e vlerësuar sipas ofertës për sistemin e baterive për ruajtje të energjisë elektrike	_____ Euro
3. Informacion mbi Kompaninë Instaluese	
Emri i biznesit të instaluesit:	
Numri i biznesit të instaluesit (NUI):	
E-mail adresa:	
Numri i telefonit	
4. Kriteret e zgjedhura për verifikim	
Të dhënat e pajisjes:	Kriteret e kërkuara për verifikim <i>(shënoni me X nëse plotësohet kriteri)</i>
Teknologjia: Litium-ion (Li-ion)	☐ Cikli jetësor $\geq 6,000$ cikle në DoD 80% ☐ Eficienca $\geq 85\%$ dhe DoD $\geq 80\%$ ☐ I pajisur me certifikatën e konformitetit CE.
5. Kriteret minimale teknike të kërkuara: (shënoni me një X nëse plotësohet kriteri)	
	☐ Teknologji litium-ion me certifikim CE dhe IEC 62619 ☐ Garancia për të paktën 10 vjet dhe kapacitet akumulues $\geq 70\%$ pas 10 vjetësh ☐ Cikli jetësor $\geq 6,000$ cikle në DoD 80%. ☐ Eficienca e ciklit të plotë $\geq 85\%$.

Teknologjia: Litium-ion (Li-jon)	☐ Thellësia e shkarkimit (DoD) $\geq 80\%$. ☐ Sistemi i baterive është në përputhje me Ligjin Nr. 08/L-258 për Burimet e Energjisë së Ripërtërishme (Neni 28, paragrafi 2.2.1–2.2.2), që do të thotë se mund të mbushet me energji elektrike vetëm nga stabilimenti për vet-prodhim me burime të Ripërtërishme (sistem solar FV) dhe jo nga rrjeti elektrik. Çdo mbushje nga rrjeti është i ndaluar dhe konsiderohet përdorim i paautorizuar i energjisë elektrike. ☐ Sistemi përfshin SOC bazë dhe monitorimin e rrjedhës së energjisë ☐ Gama e temperaturës së funksionimit: -20°C deri në 50°C ☐ Sistemi i baterisë përfshin BMS (Sistemin e Menaxhimit të Baterisë) për mbrojtje nga mbingarkesa, mbinxehja dhe polarizimi i kundërt. ☐ Pajisja është instaluar në një mjedis të mbrojtur ose IP54+ për përdorim në ambient të hapur. ☐ Sistemi i monitorimit është online dhe ofron analiza të konsumit dhe vetëprodhimit.
Deklaroj se projekti: “Sistemi i baterive për ruajtjen e energjisë elektrike” i plotëson të gjitha standardet teknike të përcaktuara në këtë Thirrje.	----- Emri dhe mbiemri, nënshkrimi i personit përgjegjës të autorizuar nga kompania instaluese dhe vula

Emri dhe mbiemri i aplikuesit

Nënshkrimi

Data

Vendi
